

PJESË NGA KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT KASKO

1. TERMA TË PËRGJITHSHME

- 1.1. Kushtet e përgjithshme të kontratës për Sigurimin "Kasko", këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit".
- 1.2. "Siguruesi" këtu më poshtë do të quhet shoqëria e sigurimeve "ANSIG" S.H.A.
- 1.3. "I Siguruari" personi i cili kryhen sigurimin "Kasko" sipas kësaj kontrate sigurimi.
- 1.4. "Përdorues" janë anëtarët e familjes të të Siguruarit që bashkëjetojnë me të, por jo studentët dhe ushtarakët me vendbanim ndryshe nga i tij, bashkëpunëtorët e tij, por jo më shumë se dy persona, emrat e të cilëve shënohen detyrimisht në "Kërkesën për sigurim" dhe "Dëshminë e sigurimit", ose listën bashkëngjitur, të cilët përdorin mjetin motorik të siguruar dhe për të cilët është i vlefshëm mbulimi në rast sigurimi.
- 1.5. "Mjet motorik" kupton një mjet motorik vetëlëvizës, tokësor, i projektuar për përdorim në rrugët publike, që përfshihet në klasifikimin e bërë.
- 1.6. "Mjet Motorik i Siguruar" kupton mjetin motorik ose rimorkion për të cilën është paguar primi i sigurimit dhe është zgjedhur periudha dhe mbulimi përkatës.
- 1.7. "Vendqëndrim i Mjetit Motorik" kuptohet vendi i prezencës me të madhe gjatë qëndrimit të mjetit motorik, i zonës së tij të vendbanimit, punës apo parkimit.

2. OBJEKTI I SIGURIMIT

- 2.1. Objekti i sigurimit sipas këtyre kushteve janë dëmet që i ndodhin vetë mjetit motorik, të ndryshme nga dëmet të cilat mbulohehen në sigurim sipas kontratës së T.P.L. të klasifikuar si të tillë sipas akteve ligjore dhe nënligjore të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike.
- 2.2. Dëmet e mjetit motorik mund të jenë: dëme totale, dëme të pjesësme, dëme në aksesorët e detyrueshëm ose të rekomanduara për rritjen e sigurisë.

3. RREZIQET E SIGURIMIT

- 3.1. Dëmtimi i mjeteve për shkak të përplasjes apo përmbysjes,
- 3.2. Thyerja e xhamave, mbulohet zëvendësimi i xhamave të përparëm, të pasëm, anësorë të cilët mund të jenë thyer si dhe çdo gërvishje të kapakut të motorit të shkaktuar nga thyerja e xhamave.
- 3.3. Nuk mbulohet:
 - 3.3.1. Dëmet në mbulohet ose perdet mbrojtëse nga dielli.
 - 3.3.2. Dëmet në xhamat të cilët nuk janë të përfshirë në "Katalogun e prodhimi" por janë të vendosur nga "I Siguruari".

4. ZJARRI, EKSPLOZIONI DHE RRUFEJA

- 4.1. Janë të mbuluara dëmet nga Zjarri dhe Eksplozioni të cilët shkaktohen nga faktorë të jashtëm dhe përfshijnë mjetin e siguruar dhe Rrufeja e cila bie direkt mbi mjetin motorik.

4.2. NUK MBULOHEH:

- 4.2.1. Dëmet që shkaktohen nga shkaqe të brëndshme të mjetit motorik.
- 4.2.2. Dëmet që shkaktohen nga pirja e duhanit në mjetin motorik.
- 4.2.3. Dëmet, nëse nuk janë deklaruar në Rajonin e policisë apo në Repartin e zjarrfikësit.

5. KATASTROFA NATYRORE

- 5.1. Janë të mbuluara dëmet që shkaktohen nga Stuhia, Breshëri, Dëhura, Tufani, Përmbytja, Vërsëhimi.
- 5.2. Katastrofa do të mbulohet në sigurim vetëm nëse është deklaruar si e tilla nga Autoriti shtetëror.
- 5.3. Mbulohehen sipas kësaj kontrate edhe dëmet të ardhura si rezultat i përmbytjes së garazhit, edhe nëse kjo nuk ka ndodhur për shkak të përmbytjes por për ndonjë shkak tjetër (çarja e tubacioneve).

6. JANË TË PËRJASHTUARA:

- 6.1. Dëmet të cilat shkaktohen nga tërmeti dhe rrëshqitja e tokës;
- 6.2. Dëmet nga kalimi i lumenjve ose pellgjeve me mjetin motorik.

7. VJEDHJA

- 7.1. Janë të mbuluara dëmet që shkaktohen nga Vjedhja e plotë ose e pjesësme e mjetit si dhe dëmet në tentative vjedhje, me të cilën do të kuptohet çdo veprim i kundraligjshëm nga një ose disa persona kundrejt mjetit motorik të mbyllur.

8. JANË TË PËRJASHTUARA:

- 8.1. Dëmet nga vjedhja të kryera nga I Siguruari/ Përdoruesit e mjetit motorik, punonjësit e shërbimit, punonjësit të cilët ruajnë apo mbikëqyrin vendin e punës apo të parkimit.
- 8.2. Dëmet nga vjedhja të shkaktuara nga mos mbyllja e deryve, tavanëve të lëvizshme, xhamave ose në rastin kur çelësat e makinës janë lënë brenda mjetit, mbi ose përreth tij.
- 8.3. Dëmet nga vjedhja e cila ka ndodhur nga shkaqe të pashpjegueshme pa shenja e gjurmë të dukshme (vjedhje e pjesësme).
- 8.4. Dëmtimet e sistemeve dhe pajisjeve që nuk janë të nevojshëm për nisjen dhe drejtimin e mjetit, por që janë vendosur në të. Këto mbulohehen vetëm kur janë pjesë funksionale e ndërimit në bazë të mjetit motorik me përdorim special.
- 8.5. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit I Siguruari është i detyruar t'i dorëzojë Siguruesit të gjithë kopjet e çelësve.
- 8.6. I Siguruari duhet të deklarojë çdo humbje të çelësit të makinës tek Siguruasi, në rast të kundërt Siguruasi nuk mban përgjegjësi për rastin e sigurimit.

9. MBULIMET

- Mbulimi i parë:** Dëmtimi i mjeteve për shkak të përplasjes;
Mbulimi i dytë: Mbulimi 1 plus Zjarri, eksplozioni dhe rrufeja; Katastrofa natyrore;
Mbulimi i tretë: Mbulimi 2 plus Vjedhja.
- ## 10. PËRJASHTIME TË PËRGJITHSHME
- 10.1. Nuk do të mbulohehen dëmet e shkaktuara në mjetin motorik si rezultat i:
 - 10.1.1. Shpërthimit bërthamor, rrezatimit bërthamor, ndotjes radioaktive, rrezatimeve jonizuese, ndotjeve kimike;
 - 10.1.2. Luftës së çdo lloji, invazioni, luftime të tjera të armatosura, pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, lufta civile; turbullira civile, revolucioneve, lëvizjeve separatiste, kryengritje popullore, rebelime, revolta, puçe, Grushtshteti, eksode;
 - 10.1.3. Akteve terroristike, trazirave, grevave, sabotimeve.
 - 10.1.4. Dëmet në mjetin e siguruar, të bllokuar ose në tentativë bllokimi nga Organet e Shtetit.
 - 10.1.5. Dëmet e shkaktuara qëllimisht dhe/ose të udhëzuara nga personi i Siguruar.
 - 10.1.6. Dëmet që shkaktohen nga Përdorues, emrat e cilëve nuk janë shënuar në Policën e sigurimit;
 - 10.1.7. Dëmet e shkaktuara nga konsumi normal, defektet apo avaritet e brendshme elektrike, mekanike gjatë ndezjes ose lëvizjes së mjetit;
 - 10.1.8. Dëmet nga prerjet apo skopjimi i gomave, por jo dëmet që pasojnë;
 - 10.1.9. Dëmet e shkaktuara nga Përdoruesit, të pa pajisur me "Dëshminë e Aftësisë" për drejtimin e mjetit;
 - 10.1.10. Dëmet e shkaktuara nga drejtuesi i mjetit kur ky ndodhet nën ndikimin e efekteve të alkoolit, drogës ose refuzon t'i nënshtrohet provave të këtij kontrolli;
 - 10.1.11. Dëmet e shkaktuara nga humbja totale e mjetit dhe në rastin kur kjo humbje nuk shoqërohet me lëndime trupore të drejtuesit të mjetit apo të pasagjerëve;
 - 10.1.12. Dëmet e shkaktuara nga transportimi i lëndëve radioaktive, eksplozive, gërryese, ndozëse, jonizuese, etj
 - 10.1.13. Dëmet në mjetin motorik të shkaktuara gjatë kryerjes së operacioneve të shërbimit, riparimit, kontrollit, larjes, parkimit, dorëzimit ose shitjes.
 - 10.1.14. Dëmet ose humbjet e objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në momentin e rastit të sigurimit.
 - 10.1.15. Nuk mbulohet zmadhimi i humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhencës të të Siguruarit ose mosmarrjes së masave parandaluese, për parandalimin e tyre.

11. SHTRIRJA TERRITORIALE

- 11.1. Kontrata është e vlefshme vetëm për dëmet që ndodhin në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 11.2. Zgjerimi i territorit mund të bëhet me marrëveshje midis palëve, kundrejt pagesës së një primi shtesë.

12. SHUMA E SIGURIMIT

- 12.1. Shuma e sigurimit është vlera për të cilën është siguruar mjeti motorik. Shuma e sigurimit vendoset në policën e sigurimit dhe përcaktohet:
 - 12.1.1. Për mjetet e reja, shuma e sigurimit është vlera e blerjes së mjetit të ri, sipas faturës nga dyqane të specializuara.
 - 12.1.2. Për mjetet e përdorura, shuma e sigurimit zgjidhet sipas vlerës së mjetit në treg në momentin e marrjes në sigurim, duke u bazuar në çmimet e referencës sipas "Katalogut të çdoganimit të mjeteve motorike" të cilit i shtohen të gjitha taksat dhe tatimet e shtetit (dogana, aksiza). Në rastin kur në Katalog nuk gjendet vlera e atij mjeti do të merret për bazë vlera e një mjeti të ngjashëm.

13. MBISIGURIMI

- 13.1. Mjeti motorik quhet i mbisiguruar në rastin kur shuma e sigurimit e kalon ndjeshëm vlerën e mjetit motorik.
- 13.2. Palët mund të bien dakort për të zvogëluar shumën e sigurimit dhe primin e sigurimit proporcionalisht.

14. NËNSIGURIM

- 14.1. Mjeti motorik quhet i nënsiguruar në rastin kur shuma e sigurimit është më e vogël se vlera e mjetit.

- 14.2. Me ndodhjen e dëmit, vlera e dëmshpërblimit do të shumëzohet me koeficientin e nënsigurimit. Ky koeficient është raporti i shumës së siguruar me vlerën e mjetit.

15. NJOFTIMI I RASTIT TË SIGURIMIT

- Në rastin e ndodhjes së një ngjarje sigurimi, I Siguruari ose përfaqësuesi ligjor i tij duhet:
- 15.1. Të njoftojë menjëherë rastin e sigurimit sipas afateve të mëposhtëme:
 - 15.1.1. Brenda 48 orëve nga momenti i ndodhjes së aksidentit. Ky njoftim do të kryhet pranë filialit, në territorin e së cilës ndodhet agjencia që ka lëshuar kontratën e sigurimit ose pranë filialit më të afërt.
 - 15.1.2. Brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes së ngjarjes në rastin e vjedhjes. Ky njoftim duhet të bëhet pranë Organeve të Policisë dhe Siguruesit.
 - 15.1.3. Brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes të rastit të sigurimit në rastin e zjarrit, eksplozionit dhe rrufesë. Ky njoftim duhet të bëhet pranë Repartit zjarrfikës dhe Siguruesit.
 - 15.1.4. Brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes apo konstatimit të rastit të sigurimit, në rastin e thyerjes së xhamave. Njoftimi do të kryhet pranë filialit në territorin e së cilës ndodhet agjencia që ka lëshuar kontratën e sigurimit.
 - 15.1.5. Siguruasi i vihet në dispozicion një kopje e denoncimit pranë këtyre organeve dhe "Njoftimi i Rastit të Sigurimit" jo më vonë se 48 orë nga momenti i ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.
 - 15.1.6. "Njoftimi i Rastit të Sigurimit", i përgatitur më parë nga Siguruasi duhet të plotësohet me besnikëri dhe në afatet e mësipërme, pa shtrembërim të fakteve të rastit të sigurimit nga I Siguruari. Në rast të kundërt, Siguruasi ka të drejtë të çlirohet nga detyrimet për pagesën e dëmit.

16. VLERËSIMI I DËMIT

- 16.1. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, I Siguruari duhet të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim brenda afateve të përcaktuara nga Kodi Civil, vetëm pasi ka bërë njoftimin e rastit sipas formularit standart "Njoftimi i Rastit të Sigurimit".
- 16.2. Siguruasi ka të drejtë që brenda 10 ditëve të verifikojë vërtetësinë e ndodhjes së rastit të sigurimit si dhe madhësinë e dëmit. Siguruasi përfundon ekspertimet e nevojshme, ndërsa mjeti mbahet pa u riparuar nga I Siguruari gjatë kësaj periudhe.
- 16.3. Kërkesa për dëmshpërblim i drejtohet filialit, në territorin e së cilës ndodhet agjencia që ka lëshuar kontratën. I Siguruari është i detyruar të paraqesë të gjitha dokumentet e nevojshme që kanë lidhje me rastin e sigurimit.
- 16.4. Vlerësimi i dëmit duhet të jetë brenda shumës së sigurimit.
- 16.5. Në rast mosmarrëveshje, por vetëm pasi Siguruasi ka ofruar vlerësimin e tij, të dy palët krijojnë një komision arbitrazh të paanshëm me pjesëmarrjen e ekspertëve të secilës palë dhe të një eksperti të tretë. Shpenzimet e këtij komisioni përcaktohen në momentin e krijimit të tij dhe perballohet nga palet.

17. PAGESA E DËMIT/ DËMSPËRBLIMI

- 17.1. Siguruasi do të paguajë të Siguruarin / Trashëgimtarin ligjor të tij, për dëmet në mjetin motorik të siguruar deri në shumën e sigurimit duke zbritur pjesën e zbritëshme të përcaktuar në Policën e sigurimit.
- 17.2. Siguruasi ka detyrimin të paguajë dëmin brenda afatit prej 30 ditësh, pas pranimit të njoftimit të "Rastit të Sigurimit" dhe pas dorëzimit të dokumentave të nevojshme nga ana e të Siguruarit.
- 17.3. Në qoftë se mjeti është vjedhur, Siguruasi, pas 60 ditëve duhet të parapaguaj një pjesë të dëmshpërblimit, deri në 60% të shumës së sigurimit.
- 17.4. I Siguruari do të njoftojë brenda 15 ditëve nga ndodhja e vjedhjes nëse mjeti i vjedhur gjendet.
- 17.5. Në rast se nuk është dhënë parapagimi, mjeti motorik i gjetur do të vihet në dispozicion të të Siguruarit, ndërsa Siguruasi paguan dëmet që mund të këtë pësuar mjeti dhe që janë të mbuluara në sigurim.
- 17.6. Në rast se është bërë parapagimi nga Siguruasi, mjeti motorik i gjetur duhet të vihet në dispozicion të tij, ndërsa të Siguruarit do t'i paguhet pjesa e parapaguar deri në shumën e sigurimit. I Siguruari ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer parapagimin e bërë nga Siguruasi duke reduktuar nga kjo pagesat për dëmet që mund të ketë pësuar mjeti.
- 17.7. Pjesa e parapaguar deri në shumën e sigurimit duke zbritur pjesën e zbritëshme, duhet paguar kur të gjitha procedurat investiguese janë mbyllur, por jo më shumë se 2 vjet.
- 17.8. Në rast se është kryer pagesa e dëmit deri në shumën e sigurimit dhe mjeti gjendet, ai do të vihet në dispozicion të Siguruesit. I Siguruari ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer pagesën që i është bërë.
- 17.9. Në rast se I Siguruari nuk është dakord me dëmshpërblimin e ofruar, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit nga Siguruasi, duhet të paraqesë refuzimin me shkrim.
- 17.10. Në rast se I Siguruari ka bërë deklaratë të reme, është implikuar në veprime mashtrimi duke përveçuar me të padrejtë një dëmshpërblim, Siguruasi ka të gjitha të drejtat e personit të dëmtuar kundër tij.
- 17.11. Siguruasi do të rimbursojë për shpenzimet e transportit e të ngarkim-sharkimit nga vendi i ndodhjes së rastit të sigurimit (për mjetin që nuk vetëlëviz) deri në vendmbërritje.
- 17.12. Siguruasi paguan shpenzimet e ruajtjes nga momenti i rastit të sigurimit deri në përfundim të ekspertizës së nevojshme, por jo më shumë se 1,000 lekë gjithsej.

I SIGURUARI